



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 75/2012
Prishtinë, më 18.09.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Teuta Sahatqija, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Dukagjin Shala dhe Fazile Bektashi- MZHE; Ahmet Tmava, Selvete Grajqevci- Pllana dhe Ibush Jonozi- KPMM; Ukë Gashi – ZPRK; Haxhi Gashi –USAID/GFSI Burim Ejupi– INDEP dhe Florije Mehmeti –KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.09.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit të Grupit punues për hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.09.2012

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 14 .09.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Grupit punues për hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale

Kryetari – Tha se Grupi i punës ka nxjerrë një raport dhe sot e ka sjellë për diskutim të gjerë në Komision. Më pas, fjalën ia dha kryesueses së Grupit të punës, znj. Sala Berisha – Shala për të paraqitur Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

Sala Berisha –Shala – Tha se Grupi i punës ka mbajtur disa takime pune dhe një punëtori, ku kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomike - MZHE-ja dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM-ja. Si Grup punues kemi hartuar Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet dhe janë nxjerrë 45 nene. Pastaj hapi debatin për secilin nen.

Dukagjin Shala (MZHE) – Propozoi që te Nenin 2, paragrafi 17 të projektligjit, pas fjalës “ruajtjen” të shtohet fjala “ekspozimit”.

Komisioni përkrahu propozimin e MZHE-se.

Visar Ymeri – Propozoi që te Nenin 2, paragrafi 20 të projektligjit të riformulohet titulli si vijon: “Marrëveshja për të drejtën e qasjes në pronë - ”.

Komisioni përkrahu propozimin e z. Ymeri.

Ahmet Tmava (KPMM) – Tha se kur kemi propozuar Nenin 14 të projektligjit ka qenë ideja që t’i jepet mundësi prodhimit zejtar ose artizanal në bashkëpunim me komunën.

Dukagjin Shala (MZHE) – Propozoi që të fshihet paragrafi 1 dhe 2 dhe të mbetet siç është në ligjin bazik, pra që çdo resurs të jepet përmes procedurave tenderuese.

Visar Ymeri – Tha se nuk sheh asgjë të keqe që të futet si kategori ligjore edhe shfrytëzimet zejtare dhe pastaj KPMM të gjejë mekanizmat që rregullojnë më në detaje këtë fushë.

Sala Berisha - Shala- Tha se të dyja propozimet e kanë arsyeshmërinë e vetë, mirëpo në si Komision të procedojmë përmbajtjen e dy paragrafëve të Nenit 14 dhe pastaj në procedurat e mëtejshme në Kuvend të rregullohet kjo çështje.

Komisioni përkrahu propozimin e znj. Berisha –Shala.

Dukagjin Shala (MZHE) – Propozoi që në mes të paragrafit 7, të Nenit 14 të përfshihet ose të zëvendësohet teksti i paragrafit me këtë propozim: “Komiteti për PPP i rekomandon Qeverisë vendimin për aprovim me të cilin konstaton se ka interes publik në lëshimin e kësaj licence për një investitor specifik. Qeveria nxjerr një vendim të tillë, të cilin e dërgon për miratim në Kuvend. Pas miratimit nga Kuvendi,“. Propozoi që në Neni 24, nënparagrafit 1.11.1 fjala “Garancia” të zëvendësohet me “Shuma e Garancisë;”. Po ashtu propozoi që te Neni 27 i projektligjit fjalia “të veçantë” të zëvendësohet me “përkatës”.

Komisioni përkrahu propozimin e MZHE-së.

Visar Ymeri – Propozoi që në Nenin 30 të projektligjit, në nënparagrafin 2.1 të fshihet teksti “Dhe deri sa të shlyhet detyrimi për rentë, nuk do të aplikohet interes (kamatë)” sepse është në kundërshtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Po ashtu propozoi që te Neni 33 i projektligjit të fshihet paragrafi 2, për shkak se është shumë më i qartë paragrafi 6 i Neni 59 të ligjit bazik.

Komisioni përkrahu propozimin e z. Ymeri.

Sala Berisha Shala – Theksoi se propozimi i KPMM-së në Nenin 35 të projektligjit duhet të riformulohet për shkak të paqartësisë. Ajo propozoi që Neni 35 i projektligjit të ketë këtë përmbajtje: 1. Neni 61 nënparagrafi 1.1 i ligjit bazik riformulohet si vijon:

1.1. pranojë ose marrë parasysh çfarëdo punësimi, ose oferte nga cilido Person i cili ka marrëdhënie afariste ose marrëdhënie tjetër me KPMM ose ka pasur marrëdhënie të këtilla me KPMM, dhe.

Komisioni përkrahu propozimin e znj. Berisha –Shala.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

2. Projektligji i dërgohet Kryesisë së Kuvendit, sipas procedurës së rregullt për procedim në Qeveri.

4. Të ndryshme

Çështje vijuese;

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Zenun Pajaziti